



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 667 Prot.

Klos, më 22 / 02 / 2024

P/VENDIM

NR. _____ datë ____ / ____ / 2024

“Për miratim fondi financiar për ndërtim muri mbajtës për mbrojtje banese me rrezik dëmtimi nga fatkeqësia natyrore, rrëshqitje masive toke”

Në mbështetje të ligjit nr. 139 datë 17.12.2015, “Për vetqeverisjen vendore”, V.K.M-në. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, të ligjit nr. 45 datë 18.07.2019, “Për Mbrojtjen Civile” dhe në V.K. të Bashkisë nr. 83, datë 26. 12. 2023, konfirmuar nga Prefekti me nr. 1276/1prot., datë 05. 01. 2024 (Buxheti i vitit 2024), i propozojmë Këshillit të Bashkisë të

V E N D O S Ë:

- I. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Klos.
- II. Të miratojë shumën 297894 (dyqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër) lek nga Fondi për Emergjencat Civile të Bashkinë Klos për të ndërtuar mur mbajtës për banesën e Z.Mehmet Selim Meta, lagja Meta, fshati Xibër Hane, Njësia Administrative Xibër të rrezikuar nga fatkeqësia natyrore rrëshqitje masive toke .
- III. Pas konfirmimit të Vendimit, për bazueshmëri ligjore nga Prefekti i Qarkut Dibër, ngarkohen strukturat përgjegjëse të Bashkisë për zbatimin e tij.

KRYETARI I BASHKISË

Valbona KOLA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. _____ Prot.

Klos, më 19/02/2024

LENDA: Relacion shpjegues.

DREJTUAR: Këshillit të Bashkisë

Klos

Të nderuar Këshilltarë!

Në mesin e muajt Janar 2024, teritorin e Bashkisë e preku rënia e dëborës dytë për periudhën dimërore 2023-2024. Rënia e dëbores ishte e menjëherëshme dhe me intensitet tw lartë. Brenda ditës së pare. në lartësit mbi 700m trashësia e saj e kalontë 30cm. Në fshatrat e thella të Njësive Administrative Xibër dhe Gurrë arriti mbi 40cm, duke sjellë vështirësi në lëvizjen normale të banorëve të këtyre zonave. Gjatë ditëve në vijimu shoqërua me temperatura të ulta dhe reshje shiu. Shkrirja e dëborës dhe reshjet e shiut shtuan prurjet e përrrenjëve malor dhe të rrëkeve, duke shkaktuar fatkeqësi natyrore si rrëshqitje masive toke nw zona me pjerrtësi dhe rënie gurësh në rrugë nacionale dhe rrugë rurale. Në fshatin Xibër Hane, në lagjen Meta të Njësisë Administrative Xibër ka rrëshqitur një masiv toke arë me përmasa 30m*2m. Ky masiv dheu me gurë dhe inerte, ka dëmtuar plotësisht një rrugë rurale tretësore lagjeje dhe i është afruar themelit të shtëpisë së banueshme të Z. Mehmet Selim Meta 50cm afër themelit të sipërm të shtwpisw, në anën veriore. Fenomeni i rrëshqitjes është aktive dhe rrezikon seriozisht shembjen e kësaj shtëpie, në të cilën janë të strehuar 5 persona (bashkëshorti, bashkëshorti dhe një nuse pa kurorë me dy fëmijë). Është emergjente largimi i masivit të dheut që kërcënon shembjen e shtëpisë dhe ndërtimi i 30m murë guri mbajtës për të parandaluar thellimin e dëmeve dhe mbrojtjen jetëve njerëzor. Prandaj kerkojmë nga ju të miratoni fondin preventivuar prej 297894(dyqind e nëntëdhjetë e shtëtë mije e tetëqind e nëntëdhjetë e katër) lek pa TVSH-ë, nga fondi i Bashkisë për Emergjencat Civile për të ndëruar një murë mbajtës të shtëpisë të Z.Mehmet Meta dhe rehabilituar dhe rrugën rurale tretësore. Muri do të ndërtohet me mundësitë e Bashkisë.

Përgj. Z. E. Civile:

Nerim Dema

N/kryetari i Bashkisë:

Bashkim DARDHA